



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA E TIRANËS**  
**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**  
**DREJTORIA E PËRGJITSHME JURIDIKE E ASETJEVE DHE LICENSIMIT**  
**DREJTORIA E LICENSIMIT DHE GJENDJES CIVILE**

## NJOFTIM

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1096, " Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe manazhimin e hapësirës publike", vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 158, datë 26.12.2019 për "Miratimin e Sistemit të taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës" (i ndryshuar), në zbatim të Kreut VIII, neni 68, të Vendimit nr.130, datë 15.11.2018 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Vendimit të Kryetarit nr. 294, datë 05.06.2024 për zhvillimin e aktivitetit tregtar nëpërmjet vendosjes së kioskave në hapësirat publike të miratuara nga Bashkia Tiranë shpallen **180-220 vende** për vendosjen e tyre.

### DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

- Kërkesa e subjektit aplikues;
- Deklaratë e përgjegjësisë së aplikuesit;
- NIPT/ (dokument origjinal ose fotokopje e noterizuar);
- Ekstraktin e thjeshtë dhe historik të lëshuar nga QKB, (dokument origjinal);
- Planvendosja me vendin/et e tregtimit të firmosur dhe vulosur nga person i licensuar në këtë fushë (dokument origjinal);
- Skicë ose projekt (planrivelim) për vendosjen e kioskës, (dokument origjinal);
- Plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe të treguesve të tjerë që do të realizohen;
- Librezën shëndetsore në rastet e tregtimit të mallrave ushqimor (fotokopje e noterizuar);
- Lista e produkteve merceologjike;
- Vërtetim nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin që synon të zhvillojë, (dokumentin origjinal);
- Vërtetim nga dega tatimeve që subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore apo që nuk ka detyrime të tilla, (dokument origjinal ose fotokopje e noterizuar);
- Vërtetimin e shlyerjeve të detyrimeve vendore (për subjektet e krijuara në më shumë se tre muajt e fundit që nga momenti i aplikimit, (dokument origjinal ose fotokopje e noterizuar);
- Si dhe cdo dokument tjetër bazuar në VKB.

## Procedura aplikimit

- Kushdo ka të drejtë të aplikojë për t'u pajisur me leje për ushtrimin e tregtisë nëpërmjet vendosjes së kioskave, vendodhja e të cilave është miratuar më parë nga Bashkia Tiranë.
- Në miratimin e kërkesës për pajisje me leje për zhvillimin e aktivitetit tregtar, kioska, do të ndiqen në mënyrë transparente plotësimi i kushteve nga çdo aplikantët, numri i punonjësve që synohen të plotësohen, punësimi i personave të përfshirë në skemat e përkrahjes sociale që përfitojnë nga Bashkia Tiranë, ofrimin falas të shërbimeve publike për qytetin dhe komunitetin për llogari të Bashkisë Tiranë.
- Shqyrtimi i kërkesës ka për qëllim të verifikoj vendodhjen, listën e produkteve që do të tregtohen, strukturën, renderat dhe dizajnin e kioskës që do të vendoset, materialet e përdorura, ngjyrat, logot, të cilat duhet të jenë në harmoni me funksionin dhe estetikën e hapësirës publike në të cilën do të vendosen.

## Tipologjia e Kioskave

- Bazamenti i kioskës nuk duhet të jetë më i madh se 180 cm x 280 cm.
- Kioskat duhet të jenë të parafabrikuara dhe me strukturë të qëndrueshme.
- Mbulesa me formë variable, material mat alumini me lartësi 20 cm x 80 cm dhe struktura jo më e madhe se 380 cm x 300 cm.
- Streha nuk mund të jetë e dalë më shumë se 50 cm nga trupi i kioskës.
- Dera me përmasa 180 cm x 70 cm.
- Veshje me llamarinë xingato të lyer me bojë elektrostatische.
- Vendosja elementëve reklamues me një sipërfaqe jo më shumë se 1 m<sup>2</sup>.
- Instalimet elektrike përkatëse, automat qëndror dhe priza.
- Ndriçimi spote led.
- Hapësirë ekspozuese (rafe me kënd 45 gradë, të realizuara me llamarinë xingato me lyerje).
- Dritaret material xham, të ketë mbulesë me qepen metalik të lyer me hapje mbydhje manuale.
- Dyshemeja e realizuar me llamarinë alumini të kodrinuar.

## Funksionimi i aktivitetit tregtar të kioskave

- Subjektet që kryejnë aktivitetin e tyre nëpërmjet vendosjes së kioskave në hapësira publike duhet të mos zënë sipërfaqe më të mëdha se ajo e miratuar në lejen përkatëse.
- Leja të vihet në dispozicion nga subjekti në çdo rast që kërkohet nga organet inspektuese.
- Leja mbahet gjithnjë në kopje origjinale dhe të jë e vendosur në një vend të dukshëm.
- Orari i shitjes dhe tregtimit në kioska përcaktohet në leje dhe mund të jetë dhe 24 orëshe.
- Përgatitja për hapjen e kioskës fillon 60 min përpara fillimit të përcaktuar në lejen përkatëse dhe mbyllet jo më vonë se 60 min nga përfundimi i orarit të tregtimit. Në këtë afat kohor, kioskat nuk mund të ofrojnë shërbime për publikun dhe qytetarët.
- Tregtarët janë të detyruar të zbatojnë në mënyrë rigoroze orarin si më sipër.
- Garantimin e minimumit të lëvizshmërisë së këmbësorëve me një distancë prej 2.35 m nga fasada e subjektit tek pajisja/fasda e kioskës.
- Shërbimi në kioska nuk mund të mbyllet për më shumë se 10 ditë pa ndërprerje, pa marrë më parë miratimin e Bashkisë Tiranë.

## Mallrat që do të tregtohen dhe vendi i tregtimit

- Mallrat duhet të ekspozohen dhe të tregtohen vetëm në ambientet e brendshme të kioskave me përjashtim të gazetave dhe shtypit të përditshëm që mund të ekspozohen në pajisje ngjitur me kioskat dhe jo të fiksuar në tokë.
- Frigoriferët duhet të jenë të inkorporuar brenda strukturës së kioskës.

- Tregtarët janë të detyruar të nxjerrin në shitje vetëm artikujt e planifikuar, ku mund të shiten pije, cingare dhe sende të tjera të ngjashme kancelarie, përfshirë revistat apo gazetat.
- Në kioska ushtrohet tregtimi i përditshëm i suvenireve, kinkalerive, pijeve freskuese e ushqimeve fast-food, produkteve të duhanit, biletave të autobusit, si edhe sendeve të tjera të këtij lloji për shitje vetëm përmes sportelit.

### **Afishimi i çmimeve**

Është i detyrueshëm afishimi i çmimeve të shitjes. Tregtari në mënyrë të dukshme duhet të afishojë etiketat e çmimeve të mallrave të ekspozuara për shitje.

### **Kontrolli higjiëno-sanitar**

Tregtimi i artikujve ushqimorë i nënshtrohet mbikqyrjes dhe kontrollit të autoriteteve shëndetsore. Të gjithë tregtarët duhet të jenë të pajisur me librezë shëndetësore. Ata duhet t'i nënshtrohen të gjitha kontrolleve periodike dhe të respektojnë të gjitha rregullat e nxjerra nga organet kompetente.

### **Pastrimi**

1. Pastrimi i brëndshëm i kioskës dhe ambjentit përreth në një sipërfaqe 2 m<sup>2</sup> përreth saj do të kryhet nga subjekti që ushtron aktivitetin menjëherë pas mbylljes sipas orarit të caktuar në lejen e lëshuar nga Bashkia Tiranë.
2. Njëkohësisht është e detyrueshme për çdo tregtar mbajtja pastër e vendit të tregtimit. Ata në asnjë rast nuk duhet të hedhin përtokë mbeturina apo mbetje të çfarëdo lloji, por duhet t'i grumbullojnë ato në vendet e caktuara për këtë qëllim.

### **Shkeljet**

1. Përvec shkeljeve të përcaktuara në VKB nr.130, date 15.11.2018, i ndryshuar, për shkak të specifikave të aktivitetit konsiderohen shkelje dhe rastet në vijim:
  - Shkelja e rregullave të përcaktuara për tregtimin në këto struktura të përkohshme, kioska, sipas këtij vendimi apo legjislacionit të fuqi.
  - Provohet se subjekti ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e lejes dhe/ose gjatë ushtrimit të aktivitetit;
  - Shkelen kushtet e vendosura në leje.
2. Në këtë rast organi inspektues vepron në përputhje me parashikimet e pikës 10.3; 10.4; 10.5 dhe 10.6 të Kreut I, të kësaj VKB-je.